



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

Bordi i Entit Rregullator të Energjisë, në mbledhjen e tij të datës 13.04.2022, mori në shqyrtim praktikën e përgatitura nga drejtoritë teknike të ERE-s, dhe u shpreh si më poshtë:

1. Mbi miratimin e procesverbalit të mbledhjes së bordit të ERE-s më datë 11.04.2022.
2. Mbi shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë OST sh.a. për tarifën e transmetimit të energjisë elektrike për vitin 2022 dhe periudhën 2022-2024.
3. Mbi shqyrtimin e aplikimit të tarifave të operatorit të sistemit të shpërndarjes për vitin 2022.
4. Mbi vlerësimet e ERE për kostot e aktivitetit të Furnizuesit të Shërbimit Universal për periudhën 1.05.2022 – 31.12.2022.
5. Mbi përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga furnizuesi i mundësisë së fundit për muajt Janar - Shkurt – Mars 2022.
6. Mbi propozimin e shoqërisë OST sh.a., për rregullat e tregut shqiptar të balancimit të energjisë elektrike, miratuar me vendimin nr. 106, datë 02.07.2020.
7. Mbi licencimin e shoqërisë “M.C. INERTE LUMZI” sh.p.k. në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.
8. Mbi fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë “Green Energy Bilisht” sh.p.k, në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik, me kapacitet të instaluar 2000 kW.